URDHËR
Nr. 765, datë 6.12.2013

PËR RREGULLAT E ORGANIZIMIT DHE FUNKSIONIMIT TË KOMITETEVE AD HOC

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës, të paragrafit 2 të nenit 7 të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001 "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar dhe të nenit 43, pika 4, të ligjit nr. 109/2013 "Për administratën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Krijimin e komiteteve *ad hoc*, pranë Ministrisë së Drejtësisë, për rekrutimin, promovimin dhe lëvizjen paralele në shërbimin civil gjyqësor.

2. Komiteti *ad hoc* ngrihet nga struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë.

3. Komiteti *ad hoc* përbëhet nga pesë anëtarë, si më poshtë:

a) Kryetari i gjykatës ku janë shpallur vendet e lira, në cilësinë e drejtuesit të komitetit;

b) një gjyqtar i asaj gjykate;

c) kancelari i gjykatës;

ç) një përfaqësues i strukturës përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore në Ministrinë e Drejtësisë;

d) një gjyqtar i gjykatës ose, sipas rastit apo nevojës, një pedagog i Fakultetit të Drejtësisë ose ekspert në fushën, për të cilën është shpallur vendi i lirë.

4. Për kryerjen e funksionit të tij, komiteti *ad hoc* bazohet në vlerësimin e aftësive profesionale të kandidatëve, nëpërmjet një konkurrimi të hapur, të shpallur nga struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore, në Ministrinë e Drejtësisë. Shpallja e vendeve të lira në gjykatë bëhet me kërkesë të kancelarit. Njoftimi i shpalljes së vendeve të lira bëhet në faqen zyrtare të Ministrisë së Drejtësisë.

5. Struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore, në Ministrinë e Drejtësisë, vë në dispozicion të komitetit *ad hoc*, dokumentacionin e kandidatëve që kanë aplikuar për vendin e lirë.

6. Komiteti *ad hoc* i propozon Ministrit të Drejtësisë emërimin e kandidatit të vlerësuar maksimalisht, bazuar në përvojën profesionale, publikimet shkencore dhe aftësitë e veçanta të tij. Përzgjedhja e kandidatit bëhet nëpërmjet një procesi transparent e të drejtë, si dhe duke respektuar parimet e shanseve të barabarta, të meritës, aftësive profesionale e mosdiskriminimit.

7. Komiteti *ad hoc* merr vendime në praninë e të gjithë anëtarëve.

8. Në përfundim të procesit, anëtarët e komitetit *ad hoc* nënshkruajnë procesverbalin e hartuar nga struktura përgjegjëse për personelin e administratës gjyqësore, në Ministrinë e Drejtësisë.

9. Anëtari i komitetit *ad hoc*, i përcaktuar në shkronjën "d" të pikës 3 të këtij urdhri, përfiton shpërblim për pjesëmarrje, sipas legjislacionit në fuqi.

10. Ngarkohen Drejtoria e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë, në Ministrinë e Drejtësisë, gjykatat e shkallës së parë dhe gjykatat e apelit për zbatimin e këtij urdhri.

11. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I DREJTËSISË
Nasip Naço